



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR FOND ZA ZDRAVSTVENO OSIGURANJE HEALTH INSURANCE FUND	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit.	Nr. Prot. Bros Prot. Prot. No.
FSSH	922
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	Data Datum Dat.
- 20 -	22.04.24
PRISHTINË, PRISHTINA, PRISTINA	

Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

Fondi për Sigurime Shëndetësore - Fond za zdravstveno osiguranje - Health Insurance Fund

Vendimi Nr. 10/2024

Prishtinë, 22 prill 2024

Bazuar në neni 25 të Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare Nr. 19, datë 21.07.2022), udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit të përcaktuar me Metodologjinë për Planet e Integritetit, të miratuara nga Agjencia për parandalimin e Korrupsionit si dhe në bazë të dispozitave të nenit 28 paragrafi 14 Ligjit për Sigurimet Shëndetësore Nr. 04/L-249 neni 17, i Statutit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, Drejtori i Fondit për Sigurim Shëndetësor merr:

V E N D I M

1. Miratohet Plani i Integritetit i Fondit për Sigurim Shëndetësor.
2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Bujar Kaçuri
U.D. Drejtor i Fondit për Sigurim Shëndetësor

Vendimi iu dërgohet:

- Stafit të FSSH-s
- Arkivit të FSSH-së



FONDI I SIGURIMEVE SHËNDETËSORE



1

TABELA E PËRMBAJTJES

I. DEKLARATA E INTEGRITETIT	3
II. HYRJE.....	4
III. PLANI PËR INTEGRITET	5
IV. PARIMET E MENAXHIMIT TË INTEGRITETIT	6
4.1. Udhëheqja.....	6
4.2. Përfshirja e Personelit	6
4.3. Qasja Sistemore.....	7
V. OBJEKTIVAT E PLANIT TË INTEGRITETIT	7
VI. PROCESI I ZHVILLIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT.....	9
6.1. Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit.....	9
6.2. Metodologjia e vlerësimit të rrezikut	10
6.2.1. Matrica e vlerësimit të rrezikut	11
6.2.2. Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut	12
VIII. MONITORIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT DHE RAPORTIMI.....	12
IX. FUSHAT E RREZIKUT	15
9.1. Fushat e përgjithshme të rrezikut	15
9.2. Fushat specifike të rrezikut.....	15
Plani i Integritetit.....	16

I. DEKLARATA E INTEGRITETIT

Plani i Integritetit i Fondit për Sigurime Shëndetësore (FSSH) synon të kontribuojë në ndërtimin e një administrate profesionale dhe të modernizuar në funksion të krijimit të qëndrueshmërisë financiare e cila siguron përmbushjen e nevojave të qytetarëve për shërbime shëndetësore, aplikimit të praktikave inovative teknologjike, efikasitet në ofrimin e shërbimeve dhe qëndrueshmëri financiare si garantues i drejtpërdrejtë për mbrojtje shëndetësore me kosto të përballueshme për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Përmes Planit të Integritetit, do të promovohet Transparenca dhe Llogaridhënia në mënyrë që Fondi për Sigurime Shëndetësore të përmbushë rolin e tij në zbatimin e politikave për përmirësimin e gjendjes shëndetësore dhe mbrojtjen nga rreziku financiar i popullatës, në pajtueshmëri me Ligjin për Sigurime Shëndetësore dhe akteve tjera nënligjore si dhe politikave të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Plani i Integritetit është gjithashtu i harmonizuar me obligimet strategjike, të përcaktuara nga Strategjia Kundër Korrupsionit 2021-2023 dhe Plani i Veprimit Kundër Korrupsionit 2021-2023¹, në të cilat parashihet roli kyç i administratës shtetërore në zhvillimin dhe implementimin e kornizës së integritetit.

Fondi për Sigurime Shëndetësore përmes këtij Planit të Integritetit synon promovimin e profesionalizmit, efikasitetit, kulturën organizative, llogaridhënien dhe transparencën në raport me qytetarët me qëllim që të kthejmë integritetin dhe etikën në shtylla kyçe të sistemit tonë të menaxhimit. Me Planin e Integritetit, ne do të zbatojmë në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse standardet, parimet dhe objektivat në parandalimin e korrupsionit dhe sjelljeve tjera të paligjshme dhe joprofesionale. Përmes identifikimit të rreziqeve do të nxjerrim masat adekuate që ndikojnë në forcimin e integritetit dhe kulturën administrative kundër korrupsionit në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore.

¹ Strategjia Kundër Korrupsionit 2021-2023

<https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/Strategjia-Kunder-Korrupsionit-2021-2023.pdf>

Plani i Veprimit Kundër Korrupsionit 2021-2023

<https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/Plani-i-Veprimi-kunder-Korrupsionit-2021-2023.pdf>

Fondi i Sigurimeve Shëndetësore është i angazhuar për forcimin e parimeve etike të punës administrative, të cilat do të kontribuojnë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në institucion. Për këtë arsye FSSH ka hartuar dokumentin e Planit të Integritetit, ku trajtohen çështje të rëndësishme për sistemin e menaxhimit të integritetit në këtë institucion. Plani i Integritetit është një instrument anti-korrupsion, që ofron kuadrin politik dhe rregullator për të forcuar rezistencën institucionale ndaj rreziqeve të integritetit.

II. HYRJE

Në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe “Strategjinë Shtetërore Kundër Korrupsionit” të cilat obligojnë të gjitha institucionet në Republikën e Kosovës të zhvillojnë dhe miratojnë planet e integritetit, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2024 -2026.

Plani i Integritetit është një mjet për vendosjen dhe verifikimin e integritetit të FSSH-së dhe është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cenueshmërisë dhe ekspozimin ndaj praktikave jo etike dhe të korrupsionit. Plani i Integritetit është dokument operativ që buron në bazë të dokumenteve të cilat burojnë dhe janë pjesë e funksionimit të institucionit, i cili ofron masa të mbështetura tek rreziku për të arritur objektivat e integritetit të FSSH-së. Plani i Integritetit rithekson përkushtimin e FSSH-së për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet dhe veprimtarinë e tij, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve efikase, transparente, llogaridhënëse dhe të orientuara kah përmbushja e kërkesave dhe nevojave të qytetarit.

Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të FSSH-së në forcimin e sundimit të Ligjit, vlerat dhe standardet profesionale. Ky Plan paraqet bindjen e plotë në integritet të deklaruar nga ana e FSSH-së, që është përcaktuar që të mbajë qëndrim pro aktiv ndaj shkeljeve potenciale të integritetit dhe të sigurojë se suksesi i masave reformuese nuk është viktimë e kërcënimeve ndaj integritetit që bëhet përmes masave abuzive të grupeve të fuqishme të interesit, apo abuzimeve dhe rezistenca nga brenda. Plani i Integritetit synon të arrijë rezultate të qëndrueshme.

III. PLANI PËR INTEGRITET

Plani për Integritet është një dokument strategjik dhe operativ që konsiderohet si një mjet i rëndësishëm për fuqizimin e integritetit institucional. Ky Plan kuptohet si një respektim i drejtpërdrejt i vlerave morale, standardeve profesionale dhe i rregullave të zbatueshme normative.

Plani i Integritetit të FSSH-së ofron masat adekuate të cilat janë të mbështetura tek rreziku për të arritur objektivat e integritetit të institucionit.

Plani i integritetit mundëson:

- Identifikimin e rreziqeve përkatëse të korrupsionit në fusha të ndryshme të punës në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore;
- Vlerësimin e çfarëdoj rreziku që mund të paraqes rrezik për shfaqjen e korrupsionit për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore;
- Përcaktimin e masave për të parandaluar ose eliminuar rreziqet e korrupsionit dhe sjelljeve tjera joprofesionale.

Plani i Integritetit do të kontribuojë në mënyrë domethënëse në:

- Rritja e mundësive që Fondi të arrijë objektivat e tij organizative, duke vënë përpara një menaxhim pro aktiv të rrezikut të integritetit. Kjo do të përmirësoj rezistencën organizative ndaj korrupsionit potencial dhe do të zvogëloj mundësit për korrupsion;
- Përqendrimi tek prioritetet në bazë të identifikimit dhe vlerësimit të rrezikut që do ti ndihmoj Fondit të shpërndaj në mënyrë efektive burimet në dispozicion për parandalim të korrupsionit potencial, që të shfrytëzohen në mënyrën më të mirë të mundshme.

IV. PARIMET E MENAXHIMIT TË INTEGRITETIT

Integriteti tashmë është bërë standard krahas të cilit vlerësohen individët, institucionet madje edhe shtetet. Më rëndësi në rritje që lidhet me luftimin e korrupsionit dhe ruajtjen e integritetit, palët e interesit në mbarë botën, përfshirë edhe shtetin tonë po kërkojnë gjithnjë më shumë siguri që organizatat të operojnë sistem të menaxhimit të integritetit që bazohet në vlerësim të fuqishëm të rrezikut të integritetit dhe kështu të ndjekin synimet e veta në një mjedis të sigurt.

Sigurimi i integritetit më pas bëhet i dobishëm për aftësinë e organizatës/institucionit që të përmbushë në praktikë zotimet e veta ndaj palëve të interesit, me planifikimin e integritetit që është shtylla e saj themelore.

Menaxhimi i integritetit, në krahasim me kontrollin e korrupsionit apo sigurimin e integritetit, më së miri pasqyron rëndësinë gjithëpërfshirëse të integritetit në të gjitha operimet e institucionit.

Të bazuara në Metodologjinë e Planit të Integritetit të hartuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit dhe të përshtatura me nevojat e institucionit ky Plan i Integritetit do të fokusohet në këto parime:

4.1. Udhëheqja

Menaxhmenti i lartë duhet qartazi dhe dukshëm të demonstrojë një përkushtim aktiv të bazuar në fakte për integritetin. Kjo do të kërkonte nga ata që të udhëheqin procesin qysh nga fillimi, përmes zhvillimit të politikave të integritetit dhe Kodit të Etikës. I rëndësishë kritike është që ky përkushtim të jetë i vazhdueshëm dhe që të kuptohet dhe të shihet mirë nga i gjithë stafi dhe palët e interesit. Kjo do të arrihet përmes një aplikimi sistematik të politikave, procedurave dhe praktikave të menaxhmentit ndaj aktiviteteve të komunikimit, konsultimit, vendosjes së kontekstit dhe identifikimin, analizimin, vlerësimin, monitorimin dhe rishikimin e rrezikut të integritetit në Fond.

4.2. Përfshirja e Personelit

Pjesëmarrja e gjithë stafit është shumë e rëndësishme në zbatimin e suksesshëm të sistemit për menaxhimin e integritetit. Megjithatë, përfshirja kuptimplote kërkon edukimin e përshtatshëm dhe trajnimin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me

integritetin, ngritjen e vetëdijes duke krijuar kështu besim dhe mjedis pozitiv për punë. Komunikimi efektiv i brendshëm dhe i jashtëm dhe koordinimi janë të rëndësishme për punë të suksesshme ekipore në mënyrë që të gjitha palët e përfshira të marrin dhe të mbajnë të njëjtin kuptim për projektin derisa është duke u zbatuar. Plani i Integritetit nuk nënkupton një dokument të pandryshuar, por një dokument që vendoset për një periudhë të caktuar kohore ku edhe brenda asaj periudhe mund të shqyrtohet dhe përditësohet varësisht nga nevojat dhe në përshtatje me kornizën ligjore, si dhe me ndryshimet tjera procedurale dhe të personelit në Fond.

4.3. Qasja Sistemore

Identifikimi i fushave potenciale të korrupsionit dhe menaxhimi i proceseve të ndërlidhura për të siguruar integritet kërkon qasje sistemore. Kjo kërkon nga FSSH që ti kushtoj vëmendje të gjitha komponentëve të sistemit dhe të analizoj marrëdhënien dhe ndërvarësinë ndërmjet tyre. Plani do të synoj që të zhvillohet qasja sistematike ndaj gjithë veprimtarisë në FSSH duke adresuar në mënyrë metodike të gjitha rreziqet e Integritetit që rrethojnë të kaluarën, të tashmen dhe veçanërisht të ardhmen e aktiviteteve të parapara nga FSSH.

V. OBJEKTIVAT E PLANIT TË INTEGRITETIT

Objektivi kryesor i Planit të Integritetit është të rrisë dhe vendos përpjekjet dhe burimet për të parandaluar/eliminuar në mënyrë progresive dhe sistematike shkaqet dhe efektet shkatërruese të korrupsionit dhe të sjelljeve jo etike në FSSH.

Objektivat strategjike të parapara në Planin e Integritetit në FSSH janë:

- Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe institucional të etikës dhe integritetit në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore;
- Konsolidimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore në FSSH;
- Rritja e transparencës në ndarjen e informacioneve me publikun;
- Përmirësimi i sistemit të planifikimit, monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar;
- Thjeshtëzimi ose eliminimi i procedurave të komplikuar dhe të panevojshme;
- Vendosja e standardeve.

Objektivi I: Kuadri i brendshëm rregullator mundëson standarde dhe norma etike të integritetit si dhe mundëson zhvillimin e burimeve njerëzore, që është parakusht për të siguruar një administratë efikase, profesionale dhe me integritet. FSSH do të sigurojë që parimet e vendosura në Kodin e Etikës të respektohen nga punonjësit e institucionit, në mënyrë që mekanizmat e menaxhimit të tyre të jenë në përputhje të plotë me kuadrin ligjor për konfliktin e interesave, mbrojtjen e sinjalizuesve dhe rregullat etike në institucion.

Objektiva II: Për konsolidimin e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, FSSH do të synoj ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore (trajnimet e stafit, avancim në pozitë, edukim i vazhdueshëm profesional), si dhe do të bëhet përpjekje për të përmirësuar zbatimin e politikave të menaxhimit të burimeve njerëzore, që si bazë kanë parimet e mundësive të barabarta, mos-diskriminimit, meritokracisë, transparencës, profesionalizmit dhe që garantojnë qëndrueshmërinë e punonjësve.

Objektiva III: FSSH do të mbështesë ofrimin e informacionit publik në format e të dhënave të hapura që thjeshtojnë përdorimin, analizën dhe përhapjen e informacionit, si dhe do të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme programin e transparencës.

Objektiva IV: FSSH përmes mekanizmave të brendshme dhe legjislacionit në fuqi, ka bërë përmirësime të vazhdueshme drejtë rritjes së monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar. Përmes marrjes dhe adaptimit të politikave financiare që burojnë nga institucionet politikë-bërëse në nivel vendi, FSSH ka punuar në aplikimin e sistemeve adekuate që lidhen me kontrollin e brendshëm financiar.

Objektiva V: FSSH ka synim që në të ardhmen të eliminoj procedurat që mendohen si të panevojshme dhe të komplikuar (me theks efektin e kohës, koston financiare për qytetarët dhe institucionin, eliminim të burokracisë) me qëllim të përmirësimit të efikasitetit dhe efektivitetit institucionit.

Objektiva VI: FSSH përmes Planit të Integritetit ka për qëllim vendosjen e standardeve për gjithë veprimtarin e tij, duke përfshirë objektivat e lartë-cekura por duke mos u ndalur vetëm në to.

VI. PROCESI I ZHVILLIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

Plani i Integritetit është një dokument që vlerëson integritetin e punës, integritetin institucional, pajtueshmërinë dhe mënyrën se si institucioni dhe punonjësit e tij veprojnë përmes vetëvlerësimit të ekspozimit ndaj rreziqeve, ndaj ndodhjes dhe zhvillimit të korrupsionit dhe/ose sjelljeve tjera të papranueshme etike dhe profesionale.

Plani i Integritetit kryesisht përbëhet nga:

- Regjistrimi i rreziqeve të identifikuara dhe të vlerësuara për të gjitha fushat e funksionimit të Fondit;
- Përcaktimi i masave për përmirësimin e integritetit që përshkruan në detaje të gjitha masat që duhet të zbatohen për të zvogëluar rreziqet e integritetit, si dhe afatin kohor përkatës dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e masave.

Me rastin e zhvillimit të Planit të Integritetit bëhet vlerësimi i rreziqeve të integritetit për të gjitha fushat e funksionimit të administratës në FSSH. I gjithë stafi i FSSH-së ka mundësi të marrë pjesë në vlerësimin e rrezikut të fushave të funksionimit të institucionit dhe të propozojnë masa për të përmirësuar integritetin dhe cilësinë e përgjithshme të menaxhimit si dhe ofrimin e shërbimeve.

6.1. Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit

Zhvillimi i Planit të Integritetit në FSSH është zhvilluar në disa faza si në vijim:

Faza përgatitore – Drejtori i FSSH-së ka themeluar grupin e punues ku është përcaktuar struktura e grupit punues dhe kryesuesi i tij. Grupi punues ka mbledhur informacionet e nevojshme që institucioni i ka në dispozicion për hartimin e Planit të Integritetit si dhe ka njoftuar të gjithë stafin për rëndësinë e Planit të Integritetit. FSSH harton për herë të parë Planin e Integritetit, ku Grupi punues ka marrë mbështetje teknike përmes trajnimit një ditor nga Lëvizja FOL.

Faza e vlerësimit të rrezikut të integritetit – gjatë kësaj faze kryesuesi së bashku me grupin punues kanë analizuar dokumentacionin e mbledhur (legjislacionin dhe aktet nënligjore të zbatueshme në punën e administratës së FSSH-së, përshkrimet

e vendit të punës dhe fushëveprimin e çdo departamenti brenda institucionit) si dhe çdo proces për vendimmarrje dhe ofrimin e shërbimeve. Mbi bazën e analizës së gjendjes aktuale janë përcaktuar fushat e rrezikut dhe është bërë identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve.

Faza e përcaktimit të prioriteteve dhe propozimit të masave për përmirësimin e integritetit – FSSH përmes grupit punues ka përcaktuar prioritetet për intervenimin, përcaktimin e masave për parandalimin/eliminimin e rreziqeve dhe përgjegjësitë për zbatim.

Faza e monitorimit dhe raportimit të Planit të Integritetit – FSSH si pjesë e vazhdimësisë së monitorimit të zbatimit të Planit të Integriteti institucional do të caktoj zyrtarin përgjegjës brenda institucionit që do të jetë përgjegjës për monitorimin, vëzhgimin dhe regjistrimin e rregullt të aktiviteteve që ndodhin në një Plan të Integritetit dhe procesin e mbledhjes së informacionit për të gjitha aspektet e zbatimit të Planit të Integritetit. Ndërsa, raportimi i rregullt sipas vendimit të Drejtorit të FSSH-së do të mundëson që informacionet e mbledhura të përdoren në marrjen e vendimeve që përmirëson zbatimin e objektivave të Planit të Integritetit.

6.2. Metodologjia e vlerësimit të rrezikut

Vlerësimi i rrezikut do të thotë renditja e rreziqeve më të mëdha në krye të listës, që paraqesin efekte thelbësore në integritetin e FSSH-së dhe mund të rrezikojnë efikasitetin, besueshmërinë dhe imazhin e jashtëm, të cilat janë identifikuar dhe aprovuar.

Kjo do të jetë baza për përcaktimin e masave për trajtimin e rrezikut. Prandaj, prioritetet do të përcaktohen ashtu që resurset e kufizuara në dispozicion për trajtim, mund të vendosen aty ku ndihet se janë më të nevojshme. Në përgjithësi, rreziqet e kategorizuara si të vogla, përputhen me standardet për marrje të rrezikut dhe nuk imponojnë nevojën për masa shtesë të trajtimit, por kërkojnë monitorim të efikasitetit të masave ekzistuese të trajtimit/kontrollit.

Në anën tjetër, rreziqet madhore kërkojnë trajtim të menjëhershëm me masat adekuate, për të cilat FSSH është e vetëdijshme dhe do ti kushtoj rendësi të veçantë.

6.2.1. Matrica e vlerësimit të rrezikut

Figura 1. Matrica e vlerësimit të rrezikut

Intensiteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar *Probabilitetin/Gjasën* me *Pasojën/Ndikimin*, duke përdorur Matricën e Rrezikut.

11

6.2.2. Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të korrupsionit dhe formave të tjera të dëmtimit të Integritetit, do të vlerësohet nga 1 në 100 pikë, si në tabelën e më poshtme:

Ulët	Mesatar	Lartë
1 – 15	16 – 48	49 – 100

 **Rreziku me intensitet të ulët** – mundësia e ndodhjes së korrupsionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit.

 **Rreziku me intensitet të mesëm** – ndodhja e korrupsionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik.

 **Rreziku me intensitet të lartë** – Korrupsioni ose format e tjera të dëmtimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin.

VIII. MONITORIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT DHE RAPORTIMI

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës të themeluar me vendim të Drejtorit të FSSH-së. Plani i Integritetit do të rishikohet periodikisht, do të përditësohet në përputhje me zhvillimet relevante normative, institucionale, procedurale dhe të personelit brenda mjedisit të jashtëm e të brendshëm të institucionit. Raportimi do të jetë i rregullt sikurse edhe raportimi brenda institucionit, pasi që shumica e aktiviteteve janë të vazhdueshme brenda afatit kohor që mbulon plani i integritetit institucional.

Monitorimi i vazhdueshëm për zbatimin planit të integritetit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në projektim ashtu edhe në funksionim, dhe se procedurat janë kuptuar si dhe plani i integriteti është ndjekur.

Gjithashtu monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e riskut kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm përfshirë ndryshimet e vetë-rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioritetet e rrezikut si dhe kanë identifikuar cilat mësimet duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me afatin kohor dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur. Gjithashtu, pas hartimit të raportit për zbatimin e planit të integritetit, raporti duhet të dërgohet për diskutim në mekanizmat më të lartë administrativ të institucionit.

Me qëllimi të sigurimit të zbatimit të planit krijohen mekanizmat për monitorimin dhe raportimin për zbatimin e Planit të Integritetit, si në vijim:

1. Grupi punues – emërohet me vendim të Drejtorit të FSSH-së dhe është përgjegjës për:

- Promovimin e integritetit në FSSH dhe merr masa për të parandaluar korrupsionin, konfliktin e interesit dhe format e tjera të sjelljeve jo etike;
- Hartimin e draftit të Planit të Integritetit Institucional;
- Përgatitjen e programit për zhvillimin e planit të integritetit;
- Siguron që Plani i Integritetit të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi, standardet e punës, metodat e vlerësimit të integritetit dhe me metodat e rishikimit;
- Zhvillimin e një qasje sistematike, gjithëpërfshirëse dhe të integruar ndaj rreziqeve;
- Propozimin e masave të nevojshme për eliminimin dhe parandalimin e korrupsionit, konfliktit të interesit dhe formave tjera të sjelljeve jo etike;
- Sigurimin e zbatimit, përditësimit dhe vlerësimit në bazë të vazhdueshëm të Planit të Integritetit si dhe standardet, format dhe procedurat për të mbështetur Planin e Integritetit;

Grupi punues mbaron mandatin pas hartimit të planit të integritetit të FSSH-së. Drejtori i FSSH-së themelon grupin e ri punues varësisht nga vlerësimi i nevojave.

2. **Koordinatori për mbikëqyrje të integritet** – emërohet me vendim të Drejtorit të FSSH-së dhe është përgjegjës për:

- Përgatitur metodologjinë për monitorimin e Planit të Integritetit;
- Raportimin mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- Të mbledhë dhe analizon dokumentacionin e nevojshëm në lidhje me funksionimin e institucionit, i cili është baza për vlerësimin e rrezikut dhe zhvillimin e Planit të Integritetit;
- Pranimin dhe rishikimin e informacionit për situatat, ndodhitë dhe veprimet për të cilat ekziston një besim i arsyeshëm se ato përfaqësojnë një mundësi për shfaqjen dhe zhvillimin e korrupsionit, konfliktit të interesit dhe formave tjera të sjelljeve jo etike;
- Në bashkëpunim me të gjitha Departamentet dhe Divizionet, përgatit raportet për zbatimin e Planit të Integritetit;
- Sigurimin e zbatimit, përditësimit dhe vlerësimit në bazë të vazhdueshëm të Planit të Integritetit si dhe standardet, format dhe procedurat për të mbështetur Planin;
- Harton raporte periodike për monitorimin e Planit të Integritetit dhe i raporton Drejtorit të FSSH-së.

Koordinatori, gjithashtu mbështet grupin punues në hartimin dhe përgatitjen e raporteve për zbatimin e Planit të Integritetit. Koordinatori i rekomandon Drejtorit të FSSH-së për takim me grupin punues sa herë që vlerësohet e nevojshme.

IX. FUSHAT E RREZIKUT

9.1. Fushat e përgjithshme të rrezikut

Fushat e përgjithshme të rrezikut janë:

- Drejtimi dhe menaxhimi;
- Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve;
- Planifikimi dhe menaxhimi financiar;
- Komunikimi dhe informimi;

9.2. Fushat specifike të rrezikut

Fushat specifike të rrezikut janë:

- Trajtimi Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike;

Plani i Integritetit									
Fushat e përgjithshme të rrezikut									
Regjistrimi i rrezikut				Vlerësimi dhe matja e rrezikut			Veprimi ndaj rrezikut		
Fusha e rrezikut	Përshkrimi	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve	Njësia/Zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit	
Drejtimi dhe menaxhimi	Mos miratimi i legjislacionit	Pjesëmarrja e Zyrtarëve të FSSH-së në Grupet punuese për hartim të legjislacionit	9	9	81	Shfrytëzimi i drafteve të kaluara Shfrytëzimi i memories institucionale	Drejtori	2024-2026	
	Mos-funksionalizimi i FSSH-së	Parapërgatitja që lidhen me funksionalizimin e FSSH-së	8	9	72	Hartimi i Planit të Veprimit Strategjik	Bordi Drejtues	2024-2026	
	Vonesat në miratimin e rregullores së brendshme për sistematizimin e vendeve të punës	Rregullore (qrk) Nr.04/2017 Për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore	6	6	36	Përgatitja e Draft-Rregullores konform nevojave dhe ligjeve në fuqi	Grupi Punues i FSSH-së dhe Bordi Drejtues	2024-2026	
	Mungesa e personelit të TI-së	Funksionimi vetëm me një zyrtar të TI-së	6	8	48	Rekrutimi në fushën e TI-së në përputhje me detyrimet e përcaktuara në Nenin 12 të Rregullores 04/2017 Për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore	Drejtori	2024-2026	
	Mos publikimi me kohë i dokumenteve që lidhen me afatet kohore	/	9	9	81	Zbatimi i dispozitave ligjore në fuqi	Menaxhmenti	Janar-Dhjetor 2024	

Fushat e përgjithshme të rrezikut						
Regjistrimi i rrezikut			Vlerësimi dhe matja e rrezikut		Veprimi ndaj rrezikut	
Fusha e rrezikut	Përshkrimi	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve
Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve	Mungesa e trajnimeve adekuate për stafin	Plani për Trajnime	7	7	49	Hartimi dhe Zbatimi i Planit të Trajnimeve në bazë të nevojave të stafit dhe specifikave të vendit të punës
	Vlerësimi i të punësuarve në FSSH jashtë standardeve të parapara në rregullore	Rregullorja për vlerësimin e të punësuarve në FSSH	5	7	35	Vlerësimi konform Planit të Punës së Institucionit
Fushat e përgjithshme të rrezikut						
Regjistrimi i rrezikut			Vlerësimi dhe matja e rrezikut		Veprimi ndaj rrezikut	
Fusha e rrezikut	Përshkrimi	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve
Planifikimi dhe menaxhimi financiar	Barazimet financiare me institucionet shëndetësore për TMJIShP	Komisioni i Barazimeve	9	8	71	Raportet e barazimeve me Institucionet Shëndetësore Private (Marrëveshjet kontraktuale me Spitalet ku pacientet marrin trajtim mjekësor)
						Drejtori dhe Komisioni i Barazimeve (Financat)
						2024-2026

	Mos regjistrimi i total pasurive të FSSH-së në sistem (E-pasuria)	Raportimi i pasurive të FSSH-së përmes regjistrave të brendshëm (Excel)	5	8	40	Evidentimi i secilës pasuri përmes barkodit dhe regjistrimi i të gjitha pasurive në sistemet konform rregullores 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore	Zyrtari përgjegjës	Janar-Dhjetor 2024
	Mos ndarja e buxhetit në përputhje me planifikimet e FSSH-së	Raportet për planifikim dhe ekzekutim të buxhetit	8	7	56	/	Menaxhmenti	2024-2026
Fushat e përgjithshme të rrezikut								
Regjistrimi i rrezikut			Vlerësimi dhe matja e rrezikut			Veprimi ndaj rrezikut		
Fusha e rrezikut	Përshkrimi	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve	Njësia/Zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
Komunikimi dhe Informimi	Mungesa e Planit të Komunikimit	Komunikimi bazuar në nevojë	7	8	56	Hartimi i Planit Vjetor të Komunikimit	Drejtori	Janar-Dhjetor 2024
	Mos funksionimi i ueb faqes zyrtare të institucionit	Zbatimi i dispozitave ligjore në fuqi	9	9	81	Komunikimi me përgjegjësit e mirëmbajtjes së ueb faqes zyrtare ASHI dhe zyrtarit përgjegjës në FSSH	Divizioni	Janar-Dhjetor 2024
	Mungesa e sigurisë së të dhënave duke përfshirë ruajtjen e konfidentalitetit	Dosjeve fizike të arkivimit	6	5	30	Zbatimi i dispozitave ligjore në fuqi	Drejtori	2024-2026

Fushat e veçanta të rrezikut									
Regjistrimi i rrezikut			Vlerësimi dhe matja e rrezikut			Veprimi ndaj rrezikut			
Fusha e rrezikut	Përshkrimi	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve	Njësia/Zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit	
Trajtimi Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	Mos funksionimi i Softverit të TMJISHP (për regjistrimin dhe ruajtjen e dosjeve të aplikimeve)	Evidentimi dhe ruajtja e dosjeve në regjistra të brendshëm (Folder, Excel) të FSSH-së	8	9	71	Funksionalizimi i Softverit aktual, si dhe përshtatja me nevojat e Programit për TMJISHP dhe dispozitave ligjore në fuqi	Zyrtari përgjegjës	Janar-Dhjetor 2024	
	Mungesa e kontrollit/mbikëqyrjes nga FSSH për të monitoruar vendimet e Bordit për TMJISHP dhe Trupat profesionale të Klinikave të QKUK-së	/	8	8	64	Themelimi i një mekanizmi të kontrollit dhe mbikëqyrjes së vendimarrjes së Bordit për TMJISHP dhe Raporteve Konziliare të Trupave profesionale të Klinikave të QKUK-së	Drejtori dhe Menaxhmenti i FSSH-së	2024-2026	
	Mungesa e transparencës në lëndet që dërgohen për shqyrtim tek Bordi për TMJISHP	Dispozitat ligjore (Udhëzimi administrativ nr.03/2023 TMJISHP)	6	9	54	Publikimi/Transparenca i listës së lëndëve që dërgohen në Bord për TMJISHP sipas obligimeve ligjore të përcaktuara në Udhëzimin administrativ nr.03/2023 TMJISHP	Drejtori dhe Menaxhmenti i FSSH-së	Janar-Dhjetor 2024	